REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË

Nr. Regj. Them. 16067/8393 **Nr. vend. 1011**

Dt. Regj. Them. 22.09.2025 **Dt. vend. 02.03.2026**

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e përbërë prej:

NIKO RAPI - Gjyqtar i vetëm

asistuar prej sekretares Anjeza Nergjoni, në Tiranë, sot më dt.02.03.2026, ora 14:30, mori në shqyrtim nëdhomë këshillimiçështjen civile me nr.regj.them16067/8393,dt.regj.themeltar 22.09.2025që iu përket:

KËRKUES: **Ardi Gjuzi si Person Fizik me NUIS K72428502M**, subjekt tregtar i regjistruar në QKB me përfaqësuesi ligjor Ardi Gjuzi, me adresë njoftimi në Tiranë, rruga "Blloku 50 Vjetor", shkalla 0, hyrja 1, aktualisht në IEVP "Jordan Misja", në Tiranë, njoftuar me shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, IEVP "Jordan Misja".

OBJEKTI: Fillimi i procedurës së falimentimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 13, 14, 17, 29 e vijues të ligjit nr.110/2016 "Për falimentimin".

Gjykata, pasi mori në shqyrtim *nëdhomë këshillimi*çështjen objekt gjykimi, duke iu referuar përmbajtjes së saj dhe provave shkresore bashkangjitur,

VËREN se,

A ***Paraqitja e kërkesëpadisë/kërkesës/ankimit; ligji procedurial i zbatueshëm***

A/1 Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranëështë regjistruar kërkesëpadia/kërkesa me kërkues Ardi Gjuzi Person Fizik,me anë të së cilës ka kërkuar: *"Fillimi i procedurës së falimentimit"*.

A/2 Në vijimësi të këtij gjykimi, nga ana e kësaj Gjykate (gjyqtari i vetëm Niko Rapi) **ka qenë e pamundurnjoftimi i i palës kërkuese**, sikundër kërkon ligji procedural civil, me qëllim njoftimin e kësaj pale për t'i garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe për të mos u gjykuar pa u thirrur në gjykim (neni 6 i KEDNj, nenet 41, 42 të Kushtetutës së RSH, nenet 18, 20, 128 e vijues të K.Pr.Civile).

Kështu, **pas një sërë veprimesh** për ta njoftuar, ku aktet e njoftimit janë kthyer në mënyrë të përsëritur dhe pa realizuar një njoftim të rregullt e të vlefshëm (shih: ***i)***- Vendimin datë**26/09/2026** për të metat procedurale, kthyer pa njoftim për shkak të mosgjetjes së personit në adresën e dhënë; ***ii)***- Vendimin datë**05/11/2026** për të metat procedurale, kthyer pa njoftim për shkak të mosgjetjes së personit në adresën e dhënë; ***iii)***- Vendimin datë**02/12/2026** për të metat procedurale, kthyer pa njoftim për shkak të mosgjetjes së personit në adresën e dhënë), është urdhëruar përsëritja e njoftimit ***duke shyrë afatin e lënë për të plotësuar të metat proceduale*** në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm për hapjen e procedurës së falimentimit.

Nisur nga këto rrethana faktike që kanë dalë në kuadër të këtij gjykimi, pasi ka verifikuar ekzistencën e elementeve të kërkesëpadisë/kërkesës të parashikuara nga neni 154-156 të K.Pr.Civile*(në këtë rast edhe nga ligji nr.110/2016 "Për falimentimin")*, në drejtim të plotësimit të kushteve ligjore të saj, me qëllim për të vijuar me fazat e tjera të procesit *(veprimet përgatitore dhe shqyrtimin gjyqësor)*, ka konstatuar se kjo kërkesëpadi/kërkesë ka të meta dhe nuk plotëson kushtet e parashikuara nga neni 154/a dhe 156 të K.Pr.Civile.

Në këto kushte, kjo gjykatë *(me trup gjykues monokratik, gjyqtar Niko Rapi)***me vendimin e ndërmjetëm tëdatës 19.01.2026 ka vendosur**(si tek tre vendimmarrjet e mëparshme):

1. Të konstatoj si të metë proceduriale të kërkesës në cështjen civile me nr.16067 regj.them, dt.22.09.2025 regj.them, me kërkues - "Ardi Gjuzi"PF etj, rrethanat e mëposhtme: ***(i) mosparapagimin e tarifës gjyqësore për këtë kërkim, (ii) mosdorëzimin e akteve të kërkuara nga ligji nr. 110/2016 "Për falimentin", sikundër është përcaktuar në pjesën argumentuese të këtij vendimi të ndërmjetëm.***

2. Të urdhëroj komunikimin e këtij vendimi palës kërkesë, me qëllim që kërkuesi të plotësojë të metat e kërkesës të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit.

3. Kërkuesi njoftohet se duhet të plotësojë të metat e kërkesës ***deri më datë 20.02.2026****, në të kundërt padia do të kthehet pa veprime të mëtejshme. Deri në plotësimin e të metave të kërkesës, kërkesa do të lihet pa veprime.*

Rezulton se,ky vendim i është komunikuar në IEVP "Jordan Misja" më datë 28.01.2026, kundrejt nënshkrimit, rrethanë kjo e konfirmuar nga akti "Dëftesë komunikimi", përcjëllë me shkresën e IEVP nr.537/1 prot, datë 28.01.2026 drejtuar kësaj gjykate.

Po kështu, rezulton se pas kalimit të afatit të përcaktuar në vendimin për konstatimin e të metave, këto të meta nuk janë plotësuar nga ana e paditësit, edhe pse pala**ka patur në dispozicion së paku *23ditë*** nga momenti i njoftimit, ***madje nuk ka zgjedhur as ndonjë përfaqësues*** për të kryer veprimet në emrin e tij si përfaqësues ligjor i palës kërkuese.

A/3 Duke iu referuar datës së paraqitjes së kërkesëpadisë/kërkesës në kryesekretari (paraqitur më*dt.22.09.2025*, çështja e shortuar i ka kaluar gjyqtarit *më dt.26.09.2025*), në raport me datën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligjin procedurial civil, rezulton se kjo është ***e mëvonshme*** në kohë nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.38/2017, «Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, dt.29.03.1996, «Kodi i Procedurës Civile në RSH», të ndryshuar, duke qënë se keto ndryshime kanë hyrë në fuqi mëdt.05.11.2017.

Konkretisht, sipas nenit 111 të ligjit nr.38/2017, ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa rezulton se ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr.98, viti 2017, ditën e premte më dt.05 maj 2017, për pasojë, si datë e hyrjes në fuqi do të konsiderohet dita e fundit e muajit të gjashtë: data 05 nëntor 2017.

Ndërkohë, në nenin 109/par.1 dhe 3 të ligjit nr.38/2017 të përmendur (*Dispozitat kalimtare*) thuhet se: *«1. Çështjet civile, që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë... .3. Për çështjet civile, për të cilat është vendosur prishja e*

vendimit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim, sipas neneve 467 dhe 485, shkronjat "c" dhe "ç", të këtij Kodi, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rigjykim do të zbatohen dispozitat e këtij ligji... ».

Në këto kushte, vlerësohet se në rastin konkret janë të zbatueshme dispozitat ligjore pas këtyre ndryshimeve, të cilat kishin hyrë në fuqi në momentin e paraqitjes së padisë/kërkesës/ankimit (sipas rastit) në shkallë të parë, kjo, sipas parimit se norma *proceduriale* civile ndjek një rrugë tjetër nga ajo *materiale* dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor zbatohet norma proceduriale në fuqi, për aq sa nuk ka një parashikim të ndryshëm në dispozitat kalimtare.

Në lidhje me zbatueshmërinë e normave proceduriale, referuar këtij parimi të përmendur, edhe Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim të tillë, e cila në vendimin nr.11, datë 23.04.2009, ndër të tjera, është shprehur se: *"... në të drejtën proceduriale ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe...".*

Në rastin e këtyre ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr.38/2017, rezulton se në dispozitat e tij kalimtare ky i fundit e ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga rregullat e përgjithshme për normat materiale duke e përcaktuar qartë se do të jetë **i zbatueshëm**vetëm për çështjet që nuk janë në gjykim duke u paraqitur rishtazi, pra, që vijnë në gjykatë pas hyrjes në fuqi të tij (të ndryshimeve) në formën e një kërkesëpadie, kërkese, ankimi, rekursi të ri ose në kushtet e kthimit të çështjes për rigjykim (paragrafët 1, 2, 3 të nenit 109 të këtij ligji), **sikundër është edhe çështja konkrete si njëçështjee re e sjellë për gjykim në shkallë të parë, çështje për të cilën konsiderohet se kanë efekt këto ndryshime të ligjit procedurial civil**.

Ndërkohë, ligji nr.44/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, dt.29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile i RSH", të ndryshuar, është botuar në Fletoren Zyrtare me nr.71/viti 2021, më dt.14 maj 2021 dhe sipas parashikimit të nenit 33 të tij (ku thuhet se "Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare"), rezulton që ligji ka hyrë në fuqi më dt.29 maj 2021. Parashikimi tek "Dispozitat kalimtare" (neni 32) nuk përfshin ***asnjë rregullim të ri apo të ndryshëm*** për shqyrtimin e padive/kërkesave/ankimeve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore apo të apeleve, por vetëm shqyrtimin e rekurseve në Gjykatën e Lartë, kështu që nuk ka ndonjë rregullim të posaçëm lidhur me këtë moment, përveç rregullimeve e ndryshimeve tek dispozitat proceduriale lidhur me kompetencën dhe mosmarrëveshjet për kompetencën (neni 3 i ligjit nr.44/2021 ka ndryshuar nenin 62 të Kodit, neni 4 i ligjit nr.44/2021 ka shfuqizuar nenin 63 të Kodit dhe neni 5 i ligjit nr.44/2021 ka bërë disa shtesa e ndryshime në nenin 64 të Kodit).

B ***Shqyrtimi i kërkesëpadisë së paraqitur në shkallë të parë mbi aktet dhe pa praninë e palëve, para se të kryhen veprimet paraprake, në kuadër të të metave proceduriale***

I. *Vlerësimi i padisë/kërkesës/ankimit(sipas rastit) në kuadër të të metave proceduriale, në aspektin ligjor* ***<u>të përgjithshëm</u>***

Duke iu referuar momentit të paraqitjes në kryesekretarinë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (si gjykatë e shkallës së parë) të padisë/kërkesës/ankimit (sipas rastit), nisur edhe nga parashikimet e ligjit procedurial civil pas ndryshimeve me ligjin nr.38/2017 (të zbatueshme për këtë çështje), kjo Gjykatë çmon se pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve procesi gjyqësor civil iu nënshtrohet (*tashmë*) **<u>disa fazave</u>** proceduriale që janë parashikuar shprehimisht në Kod, siç janë:

(i) Faza e veprimeve ***paraprake***, në të cilën gjyqtari i vetëm mund të kryejëveprimet dhe/apo të marrë vendimet përkatëse, respektivisht sipas nenit 158 dhe 158/**<u>a</u>** të Kodit të Procedurës Civile, dispozita këto të ndryshuara me nenet 41 dhe 42 të ligjit nr.38/2017 (sipas paragrafit të parë të nenit 158/a: «Gjykata, pasi e vlerëson padinë pa të meta në zbatim të neneve 154/a dhe 156 të këtij Kodi, i kërkon të padituri të lëshojë deklaratën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi i kërkesëpadisë…»).

(ii) Faza e veprimeve ***përgatitore***, e caktuar në rastet e detyrueshme apo sipas çmuarjes së gjyqtarit, në të cilën ky i fundit mund të kryejë veprimet dhe të marrë vendimet përkatëse sipas nenit 158/**<u>b</u>** të Kodit të Procedurës Civile, dispozitë e ndryshuar me nenin 43 të ligjit nr.38/2017.

(iii) Faza e shqyrtimit ***gjyqësor***, e cila nis pasi gjyqtari i çështjes (gjyqtari i vetëm ose gjyqtari kryesues) nxjerr urdhërin për caktimin e seancës gjyqësore, në zbatim të nenit 158/**<u>c</u>** të Kodit të Procedurës Civile, dispozitë e shtuar me nenin 44 te ligjit nr.38/2017.

Megjithatë, duke u nisur nga mënyra e strukturimit të vetë Kodit si ligj procedurial (Pjesa e Dytë***«Gjykimi në shkallë të parë»***, që përfshin nenet 153-442 te Kodit; Titulli I, «*Paraqitja e padisë, deklaratës së mbrojtjes, veprimet përgatitore*», nenet 153 deri tek neni 201 që parashikon heqjen dorë nga e drejta e padisë etj; Kreu I, «*Hartimi, paraqitja në gjykatë, njoftimi i padisë dhe veprimet përgatitore*», nenet 153-159), si edhe nga të dhënat e kësaj padie konkrete në lidhje me momentin procedurial se ku ndodhet (aktualisht është momenti i paraqitjes në gjykatë dhe kalimit menjëhere nëpërmjet shortimit tek gjyqtari i çështjes), vlerësohet se **mund të merren** në shqyrtim nga gjyqtari i vetëm elementët e padisë, për aq sa është e lejueshme dhe nuk mbivendoset me veprimet e tjera në fazat e mëvonshme të gjykimit civil.

Në këtë fazë të procesit civil, kur çështja ndodhet tek gjyqtari i vetëm, nuk ka pengesa proceduriale ligjore që tek kjo padi të analizohet, të shqyrtohet, të konstatohet (edhe pa veprime paraprake/përgatitore apo seancë konkrete, dmth pa praninë e sekretarit të seancës dhe pa u mbajtur një procesverbal nga

sekretari i seancës gjyqësore, ç'ka përbën rregullimin e përgjithshëm sipas neneve 77, 118, 118/1 të Kodit të Procedurës Civile, ndryshuar me ligjin nr.122/2013), **nëse ka apo jo të meta proceduriale** në kuptim të neneve 154, 154/a, 156 të Kodit të Procedurës Civile, dispozita këto të ndryshuara me ligjin nr.38/2017, në radhë veprimesh dhe numrash para neneve 158/a, 158/b, 158/c të përmendura më lart që normojnë fazën e mëtejshme të gjykimit civil (me veprimet paraprake, veprimet përgatitore dhe me shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë).

Gjykata mban parasysh dispozitat përkatëse që përcaktojnë kuptimin dhe përmbajtjen e «padisë/kërkesës/ankimin», ***si mjet*** procedurial (neni 31) dhe ***si akt*** procedurial që vë në lëvizje gjykatën për një gjykim civil (neni 153, 154), krahas dispozitave të tjera (shih në vijim) që lidhen posaçërisht me këtë moment të gjykimit civil (para se të kryhen veprimet paraprake, veprimet përgatitore, apo të nxirret urdhëri për caktimin e seancës gjyqësore) dhe me elementët e padisë.

Konkretisht:

Neni 31

(ndryshuar paragrafi II me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, neni 4)

Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo.

Neni 117

Përmbajtja e aktit procedural

Përveç kur ligji parashikon ndryshe, thirrja për në gjyq, kërkesëpadia e kundërpadia, duhet të tregojnë gjykatën, palët, objektin, shkaqet ligjore të kërkesës dhe përfundimet, si dhe datën e hartimit dhe duhet të nënshkruhen prej palës që e paraqet aktin ose nga përfaqësuesi i saj, si në origjinal ashtu dhe në kopjet për njoftim.

Neni 153

Hartimi i padisë

Gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim.

Neni 154

(ndryshuar me ligjin nr.8812, dt.17.05.2001; me ligjin nr.122/2013, dt.18.04.2013; ndryshuar me ligjin nr.38/2017, dt.30.03.2017)

1. Kërkesëpadia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

a) gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa;

b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të padituri dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë. Nëse paditësi ose i padituri është person juridik, emërtimin e tij ashtu siç figuron në regjistrat publikë, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ku do kryhet njoftimi;

c) objektin e padisë;

ç) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të së drejtës mbi të cilat mbështetet padia, si dhe kërkimin konkret të paditësit;

d) vlerën e padisë, në rast se objekti i saj është i vlerësueshëm.

2. Përveç këtyre kërkesave, paditësi në kërkesëpadi duhet të tregojë saktë dhe/ose të bashkëngjisë:

a) të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, ku gjykata mund ta njoftojë;

b) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim në cilësinë e dëshmitarit, duke saktësuar emrin, atësinë, mbiemrin dhe adresën e plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;

c) provat që kërkohen të merren nga i padituri dhe të tretët, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e këtyre provave;

ç) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;

d) emrin, atësinë, mbiemrin ose emërtimin nëse është person juridik dhe adresën e plotë të personave të tretë që kërkon të thirren në gjykim me këtë cilësi;

dh) aktin provues të pagimit të tarifës së padisë, sipas ligjit".

Neni 154/a

Paraqitja e kërkesëpadisë

(Shtuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 37)

Kërkesëpadia paraqitet në gjykatë nga paditësi ose nga përfaqësuesi i tij i pajisur me prokurë.Kërkesëpadia mund të paraqitet në gjykatë edhe nëpërmjet postës.

Padia iu caktohet gjyqtarëve me short.

Kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar

në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime.

Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

Kundër vendimit të gjyqtarit të vetëm për kthimin e kërkesëpadisë mund të bëhet ankim i veçantë.

Kur të metat e kërkesëpadisë janë plotësuar në afatin e caktuar, ajo quhet e regjistruar që nga dita që është regjistruar në gjykatë. Në këtë mënyrë veprohet edhe kur të metat e kërkesëpadisë konstatohen gjatë gjykimit të çështjes.

Neni 156

Aktet që i bashkëngjiten padisë

(ndryshuar fjale me me ligjin nr.38/2017, dt.30.03.2017)

Bashkë me kërkesëpadinë duhet të paraqiten:

a) prokura, në rast se kërkesëpadia paraqitet në emër të paditësit nga përfaqësuesi i tij;

b) kopje të kërkesëpadisë dhe të akteve provuese, në numër sa janë të padituri, si dhe për rastin e parashikuar nga neni 197 i Kodit Civil.

Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhet tarifa, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

Kërkesëpadisë i bashkëngjitet thirrja në të cilën shënohen data e paraqitjes në gjykatë, si dhe porosia që në këtë datë të jenë të saktësuara provat që i padituri pretendon se duhen dëgjuar nga gjykata.

II. *Vlerësimi i padisë në kuadër të të metave proceduriale dhe konstatimi i të metave proceduriale* ***<u>të kësaj kërkesëpadie/kërkese konkrete</u>***

Duke patur parasysh kërkesat e ligjit procedurial për këtë lloj padie, nisur edhe nga faza (momenti) në të cilin ndodhet çështja objekt gjykimi, rezulton se bashkangjitur kërkesëpadisë dhe në pjesën hyrëse e argumentuese të saj mungojnë disa elementë.

Në vijimësi të këtij gjykimi, nga ana e kësaj Gjykate (gjyqtari i vetëm Niko Rapi) **ka qenë e pamundurnjoftimi i i palës kërkuese**, sikundër kërkon ligji procedural civil, me qëllim njoftimin e kësaj pale për t'i garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe për të mos u gjykuar pa u thirrur në gjykim (neni 6 i KEDNj, nenet 41, 42 të Kushtetutës së RSH, nenet 18, 20, 128 e vijues të K.Pr.Civile).

Kështu, **pas një sërë veprimesh** për ta njoftuar, ku aktet e njoftimit janë kthyer në mënyrë të përsëritur dhe pa realizuar një njoftim të rregullt e të vlefshëm (shih: ***i)*** - Vendimin datë**26/09/2026** për të metat procedurale, kthyer pa njoftim për shkak të mosgjetjes së personit në adresën e dhënë; ***ii)***- Vendimin datë**05/11/2026** për të metat procedurale, kthyer pa njoftim për shkak të mosgjetjes së personit në adresën e dhënë; ***iii)***- Vendimin datë**02/12/2026** për të metat procedurale, kthyer pa njoftim për shkak të mosgjetjes së personit në adresën e dhënë), është urdhëruar përsëritja e njoftimit ***duke shyrë afatin e lënë për të plotësuar të metat proceduale*** në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm për hapjen e procedurës së falimentimit.

Nisur nga këto rrethana faktike që kanë dalë në kuadër të këtij gjykimi, pasi ka verifikuar ekzistencën e elementeve të kërkesëpadisë/kërkesës të parashikuara nga neni 154-156 të K.Pr.Civile *(në këtë rast edhe nga ligji nr.110/2016 "Për falimentimin")*, në drejtim të plotësimit të kushteve ligjore të saj, me qëllim për të vijuar me fazat e tjera të procesit *(veprimet përgatitore dhe shqyrtimin gjyqësor)*, ka konstatuar se kjo kërkesëpadi/kërkesë ka të meta dhe nuk plotëson kushtet e parashikuara nga neni 154/a dhe 156 të K.Pr.Civile.

Në këto kushte, kjo gjykatë *(me trup gjykues monokratik, gjyqtar Niko Rapi)***me vendimin e ndërmjetëm të datës 19.01.2026 ka vendosur**(si tek tre vendimmarrjet e mëparshme):

1. Të konstatoj si të metë proceduriale të kërkesës në cështjen civile me nr.16067 regj.them, dt.22.09.2025 regj.them, me kërkues - "Ardi Gjuzi"PF etj, rrethanat e mëposhtme: ***(i) mosparapagimin e tarifës gjyqësore për këtë kërkim, (ii) mosdorëzimin e akteve të kërkuara nga ligji nr. 110/2016 "Për falimentin", sikundër është përcaktuar në pjesën argumentuese të këtij vendimi të ndërmjetëm.***

2. Të urdhëroj komunikimin e këtij vendimi palës kërkesë, me qëllim që kërkuesi të plotësojë të metat e kërkesës të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit.

3. Kërkuesi njoftohet se duhet të plotësojë të metat e kërkesës ***deri më datë 20.02.2026****, në të kundërt padia do të kthehet pa veprime të mëtejshme. Deri në plotësimin e të metave të kërkesës, kërkesa do të lihet pa veprime.*

Rezulton se,ky vendim i është komunikuar në IEVP "Jordan Misja" më datë 28.01.2026, kundrejt nënshkrimit, rrethanë kjo e konfirmuar nga akti "Dëftesë komunikimi", përcjëllë me shkresën e IEVP nr.537/1 prot, datë 28.01.2026 drejtuar kësaj gjykate.

Po kështu, rezulton se pas kalimit të afatit të përcaktuar në vendimin për konstatimin e të metave, këto të meta nuk janë plotësuar nga ana e paditësit, edhe pse pala **ka patur në dispozicion së paku *23 ditë*** nga

momenti i njoftimit, ***madje nuk ka zgjedhur as ndonjë përfaqësues*** për të kryer veprimet në emrin e tij si përfaqësues ligjor i palës kërkuese.

Në rastin konkret, Gjykata (gjyqtari i vetëm) konstaton sepala paditëse/kërkuese***nuk ka depozituar asnjë akt procedurial*** lidhur me plotësimin e këtyre të metave të konstatuara dhe të komunikuara, si më sipër.

Pra, rezulton qartësisht se pala paditëse nuk ka plotësuar **asnjënga të metat** proceduriale që janë konstatuar nga Gjykata (gjyqtari i vetëm), për të cilat edhe ka ardhur në dijeni, pavarësisht detyrimeve procedurale që burojnë nga nenet 3, 4, 15, 28 dhe 100 të K.Pr.Civile, **nuk ka kryer veprimet** që i kërkon ligji në dobi të procesit *(ndërsa nuk mund të merren në shqyrtim kërkesa të tjera tënatyrës procedurale, kur konstatohet mosplotësimi i të metave të vendimit të ndërmjetëm të marrë më parë dhe që dikton edhe ecurinë e vetë gjykimit).*

Kësisoj,konstatohet se pala paditëse**nuk ka bërë përpjekjet e duhura** për të sjellë para gjykatës aktet provuese, siçështë thënë në vendimin e ndërmjetëm të përmendur, ndërkohë që përcaktimi i identitit të plotë, të saktë dhe të qartë tëpalëve + sjellja e dokumentacionit sipas ligjit nr.110/2016 "Për falimentimin" + paragimi i tarifës gjyqësore **është një detyrim ligjor për paditësin/kërkuesin** që vë në lëvizje gjykatën sipas neneve 2, 65, 68, 153, 154, 154/a, 156 të po këtij Kodi, pasi vetëm kështu mund të thirret dhe të njoftohet pala për të qenë e pranishme dhe për të mos iu cënuar të drejtat kushtetuese e ligjore për një proces të rregullt gjyqësor, të meta këto që nuk janë plotësuar, pikërisht, për shkak të mosveprimit nga pala paditëse/kërkuese **në një periudhë mëse të mjaftueshme**: më shumë se 5 muaj pas depozitimit të kërkesëpadisë/kërkesës dhe 23 ditë pas komunikimit tëvendimit të ndërmjetëm të kësaj Gjykate për konstatimin e kësaj të mete procedurale.

Përderisa, pala paditëse/kërkuese nuk ka provuar me aktin përkatës se ka kryer **brenda afatit** të përcaktuar këto veprime konkrete *për të sjellëdetyrimisht aktin/aktet lidhur me këto të meta proceduriale* të përmendura në vendimin e ndërmjetëm në kuadër të shqyrtimit në themel të padisë, konsiderohet se është **në mospërmbushje të detyrimeve proceduriale** që ka përcaktuar gjykata.

Sipas kësaj gjykate, pala paditëse nuk ka paraqitur aktet që nevojiten për të provuar se prej saj **janë kryer veprimet e duhura** dhe është demostruar një sjellje e tillë korrekte në plotësim të detyrave proceduriale dhe që do të duhet të ishin bashkangjitur kësaj kërkesëpadie/kërkese, para se të investohet Gjykata kryesisht për marrjen e tyre në kushtet e pamundësisë së provuar për palën paditëse/kërkuese.

Gjykata konstaton dhe vlerëson se pala paditëse/kërkuesenuk ka përmbushur në kohë kërkesat e ligjit procedurial për elementet e përmendur më lart në lidhje me këtë kërkesëpadi, megjithëse dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të cituara më sipër, **e detyrojnë çdo subjekt paditësqëtë tregojë kujdesin e**

duhur*(i)*që në momentin e paraqitjes së kërkesëpadisë në kryesekretari *(ii)*apo mëvonë, sipas vendimit të gjyqtarit të vetëm për konstatimin e të metave *proceduriale (si në këtë rast)*, kjo në zbatim të detyrimeve proceduriale për të provuar çdo kërkim, pretendim, prapësim dhe për të plotësuar të gjitha elementet e nevojshëm të padisë, siç parashikojnë këto dispozita të Kodit të Procedurës Civile: *neni 12* - parimi i barrës së provës; *neni 15* - detyrimi i palëve për të dhënë ndihmesën e tyre në gjykimin civil dhe ngarkimi i tyre me përgjegjësi në rast mosveprimi; *neni 19* - detyrimi i palëve që, në kohën e duhur, t'i bëjnë të ditur dhe t'i japin njëra-tjetrës pretendimet dhe provat që do të paraqesin; *neni 117* - padia si akt procedurial; *neni 31/1 dhe 153* - padia si mjet dhe si akt që vë në lëvizje gjykatën; *neni 154 dhe 156* - përmbajtja, elementët dhe aktet që i bashkangjiten padisë.

Pavarësisht prezumimit se *(si rregull)* ligji është i njohur për të gjithë shtetasit me zotësi të plotë për të vepruar dhe me zotësi të plotë proceduriale (përfshirë edhe palën apo përfaqësuesin e mundshëm ligjor të saj), rezulton se subjekti që ka vënë në lëvizje Gjykatën dhe ka kërkuar shqyrtimin e kësaj kërkesëpadie, në këtë rast nuk ka patur të depozituar **këto akte provuese** dhe as ka plotësuar të gjithë elementët e tjerë të padisë/kërkesës/ankimit, sikundër është theksuar më lart, si në momentin e paraqitjes, dhe **<u>as në përfundim të afatit</u>** të lënë nga gjykata *(nga gjyqtari i vetëmàshih vendimin e ndërmjetëm)*.

Në vijim, Gjykata vlerëson se **kjo mospërmbushje e detyrimeve proceduriale** të lëna me vendimin e ndërmjetëm për konstatimin e të metave proceduriale, pra, mosplotësimi **<u>në kohë</u>** i këtyre të metave sipas përcaktimit të bërë nga gjyqtari i vetëm, ***ka ardhurpër faj të vetë palës paditëse/kërkuese***, ç'ka e ngarkon atë me përgjëgjesi proceduriale, për të cilin në Kodin e Procedurës Civile është parashikuar **<u>si sanksion procedurial</u> kthimi i padisë së bashku me aktet**.

Për këtë vlerësim mbahet parasysh fakti që pala paditëse/kërkuese/ankuese ka patur kohën e nevojshme për të kryer veprimet konkrete në zbatim të këtij vendimi për të metat proceduriale, ***<u>së paku 23 ditë</u>*** *nga momenti i njoftimit të vendimit të ndërmjetëm, për aktet e një padie në lidhje me një mosmarrëveshje që ka lindur <u>shumë më herët</u> në kohë, aspekt që i heq edhe të drejtën e ndonjë pretendimi* ***për mungesën e kohës*** *së mjaftueshme*.

Në lidhje me pasojat proceduriale të kësaj të mete Gjykata mban parasysh se kjo është një e metë e rëndësishme për procesin dhe që kushtëzon vijimin e gjykimit, përderisa është një e metë që nuk është plotësuar **<u>në kohë</u>** sipas disponimit të gjyqtarit të vetëm, ndërkohë që vetë ligji, por edhe interesi i palëve, presupozon që shqyrtimi i kërkesëpadisë të bëhet në një kohë sa më të shpejtë, përderisa lidhet me një mosmarreveshje civile me palë kundërshtare***<u>dhe/ose</u>*** me procedura të hollësishme dokumentare sipas ligjit nr.110/2016 "Për falimentimin".

Në këto kushte, për shkak të këtyre të metave thelbësore për vetë procesin, sa që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të veprimeve proceduriale, Gjykata çmon se kjo kërkesëpadi.kërkesë duhet të mbetet pa

veprime dhe **duhet t'i kthehet palës paditëse/kërkuese** në këtë fazë të procesit (pa u planifikuar dhe as zhvilluar veprime paraprake, veprime përgatitore, seancë gjyqësore), pasi më parë është bërë me vendim konstatimi e komunikimi i të metave proceduriale *(situata **e dytë** e nenit 154/a të Kodit)*.

- Sipas kësaj Gjykate, në rastin e paditësit/kërkuesit Ardi Gjuzi Person Fizik **nuk rezulton se ky disponim cënon aksesin në drejtësi** për të vënë në lëvizje gjykatën në funksion të mbrotjes së një interesi të ligjshëm (neni 6 i KEDNj, neni 42 i Kushtetutës së RSH, nenet 2 dhe 153 e vijues të K.Pr.Civile), *përderisa nëkëtë proces, janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme që parashikon dhe mundëson ligji procedurial civil dhe legjislacioni në tërësi*, kjo për të bërë të mundur njoftimin e vetë paditësit/kërkuesit me qëllim vijimin e procesit.

Sikundër është përshkruar hollësisht më lart, *vijimi i procesit nuk është bërë i mundur jo për faj të moskryerjes së veprimeve nga gjykata, as për shkak të neglizhencës apo mosangazhimit të gjykatës si instancë gjyqësore e shkallës së parë që merr në shqyrtim një kërkesëpadi/kërkesë*, ku situata e krijuar dikton natyrshëm kthimin e padisë dhe të akteve, pikërisht, për shkak të pamundësisë sëplotësimit të të metave proceduriale të përmendura më lart, në rrethana të tilla që nuk e ngarkojnë gjykatën me përgjegjësi proceduriale.

C ***E drejta e ankimit kundër vendimit për kthimin e akteve***

Në zbatim të nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar me nenin 27 të ligjit nr.122/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, dt.29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile", të ndryshuar", vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, iu njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar, njoftim i cili bëhet sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të Pjesës I.

Në këtë rast e drejta e palës paditëse/kërkuese/ankuese për t'u njoftuar nuk humbet, përderisa:

(i) ka një vendim të gjykatës mbi kërkesën/kërkesëpadinë/ankimin e kësaj pale;

(ii) ky vendim është jopërfundimtar;

(iii) në përfundim të shqyrtimit të kërkesëpadisë ankimit palës kërkuese i njihet një e drejtë ankimimi (ankim i veçantë në rastin e kthimit te akteve), atëherë do të zbatohen të gjitha rregullat e përgjithshme të parashikuara në Kod për njoftimin e palës nga ana e kryesekretarisë, si për çdo palë që nuk ka qënë e

pranishme në marrjen/shpalljen e një vendimi (përfundimtar, jopërfundimtar apo i ndërmjetëm dhe i ankimueshëm).

Në lidhje me afatin e ankimit, konkretisht momenti i fillimit të këtij afati për ankim të veçantë (që në këtë rast është 5 ditor sipas nenit 443/par.4 të Kodit të Procedurës Civile, dispozitë e ndryshuar me ligjin nr.8812/2001) mbahet parasysh neni 444 i po këtij Kodi (dispozitë e ndryshuar me ligjin nr.8812/2001 dhe me nenin 84 të ligjit nr.38/2017), ku parashikohet se: «*Afatet e caktuara në nenin 443 janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar*».

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në nenet 127, 117, 153, 154-156, 154/a, 306-310, 443-444 të K.Pr.Civile,

V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesëpadisë, së bashku me aktet, të çështjes civile me nr.16067/8393 regj.them, dt.22.09.2025regj.them, me *kërkues*- Ardi Gjuzi si Person Fizik me aktivitet tregtar me NUIS K72428502M, me *objekt- "Fillimi i procedurës së falimentimit"*, **në këtë moment procedurial, palës paditëse/kërkuese.**

2. Kundër këtij vendimi pala paditëse mund të bëjë**ankim të veçantë** në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**brenda 5 ditëve** duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar nga ana e kryesekretarisë.

U shpall në Tiranë sot më datë 02.03.2026, ora 14:35.

SEKRETARE

ANJEZA NERGJONI

G J Y Q T A R I

NIKO RAPI

Shpenzimet gjyqësore: